



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË DIVJAKË
KOMISIONI I EKONOMISË DHE FINANCAVE

Nr 12446/22

Divjakë më 24 . 12 .2025.

RAPORT

MBI SHQYRTIMIN E PROJEKTVENDIMEVE PËR MBLEDHJEN E MUAJIT DHJETOR
2025

Të nderuar Këshilltarë!

Mbështetur në nenin 17,pika 1.2.3, të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 : “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 33, të Rregullores së Këshillit Bashkiak Divjakë,Komisioni i Ekonomisë dhe i finanave, u mbledh më datë 24 . 12 .2025 ,pasi shqyrtoi projektvendimet e paraqitur nga Bashkia,

VENDOSI :

1. Të kalojë për miratim Projektvendimin për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga Fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Nëntor 2025.
2. Të kalojë për miratim Projektvendimin për transferimin e disa funksioneve nga aparati i Bashkisë Divjakë, në shoqërinë e krijuar me VKB NR. 23 datë 24.04.2025 “ Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ Rrjela” sh.p.k dhe miratimin e Statutit dhe Aktit të themelimit”
3. Të kalojë për miratim Projektvendimin për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
4. Të kalojë për miratim Projektvendimin për miratimin e PBA 2026-2028, Buxhetit të vitit 2026, numrit të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për vitin 2026, me këto ndryshime:

Çek pika 6 ndryshohet numri maksimal i punonjësve nga 486 punonjës në 488 punonjës, Njësia shpejzuese Bashkisë Divjakë nga 1371 punonjës në 1373 punonjës.
(Ndryshimet vijnë si rezultat i një pobimi njëzëror në përfundimin e projektvendimit)

5. Të kalojë për miratim Projektvendimin mbi miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.
6. Të kalojë për miratim Projektvendimin për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, të Njësive Administrative dhe Funkcionet e deleguara , për vitin 2026.
7. Të kalojë për miratim Projektvendimin për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026. me këto ndryshime:






Në lidhjen Nr 1 shtohet numri reudor 95 me pagën e pozici onit të punës "Kameraman"
Jeg ndryshim vjen si rezultat i pobimit njëzëror, kur është hartuar Projektvendimin nga Drejtoria e Buzimeve Njerezore dhe shërbimeve të brendshme.

8. Të kalojë për miratim Projektvendimin mbi miratimin e Planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Divjakë, për vitin 2026.

Shënim. Projektvendimet u votuan nga anëtarët e komisionit me 5 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.



KOMISIONI I EKONOMISË DHE FINANCAVE

- | | | |
|--------------------|------------|--|
| 1. Fatjona Budani | Kryetar |  |
| 2. Astrit Dervishi | zv/Kryetar | |
| 3. Gojart Agolli | sekretar |  |
| 4. Roza Troshku | anëtar | |
| 5. Jurgen Shuli | anëtar |  |
| 6. Sahit Ibrahimaj | anëtar |  |
| 7. Adelaajda Çuli | anëtar |  |

